



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Kryetarja

Nr. 1325 Prot.

Tiranë, më 09.04.2024

URDHËR

Nr. 19, datë 09.04.2024

PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE, DATË 11.04.2024, ORA 10.00

Në mbështetje të nenit 7, pika 6, nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin e punimeve për periudhën 8 prill – 26 prill 2024,

URDHËROJ:

- I. Mbledhjen e Kuvendit në seancën plenare të datës 11.04.2024, ora 10:00.
- II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:
 1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 04.04.2024.
 2. Njoftime.
 3. Raporti vjetor i Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian (KKIE) për vitin 2023.
 4. Projektligj “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e marrëveshjes mbi transportin ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus (Marrëveshja Interbus) në lidhje me transportin ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar të udhëtarëve me autobus”.
 5. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian “Programin e tregut të përbashkët për periudhën 2021-2027””.
 6. Projektvendim mbi raportet e shumicës dhe pakicës të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.
 7. Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 94/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë””, i ndryshuar.
 8. Projektvendim “Për disa shtesa e ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit””, i ndryshuar.
 9. Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit””, i ndryshuar.
 10. Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, i ndryshuar.
 11. Projektvendim “Për emërimin e zonjës Mimoza Kaçi, anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv”.
 12. Projektvendim “Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Konkurrencës”.

13. Miratimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit “Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit”.

14. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.

IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Lindita NIKOLLA





SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 11 prill 2024, ora 10.00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrorit nr. 19, datë 9.4.2024 të Kryetares së Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 4.4.2024.
(Neni 44, pika 2 e Rregullores së Kuvendit)
2. Njoftime
(Neni 44, pika 3 e Rregullores së Kuvendit)
3. **Raporti vjetor i Këshillit Kombëtar i Integrimit Europian (KKIE) për vitin 2023.**
(Në mbështetje të nenit 7 pika, 1 shkronja “ë” e Ligjit nr. 15/2015 ndryshuar me ligjin nr.19/2023 “Për rolin e kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”) Paraqet raportin kryetari dhe zëvendëskryetari i KKIE-së).
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare.)
4. **Projektligj “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e marrëveshjes mbi transportin ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus (marrëveshja interbus), në lidhje me transportin ndërkombëtar të rregullt dhe të rregullt të specializuar të udhëtarëve me autobus”.**
(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)
Pyetje
Shprehet nismëtari.
Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.
Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

5. **Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian “Programin e tregut të përbashkët, për periudhën 2021-2027””.**

(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Europiane.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

6. **Projektvendim mbi raportet e shumicës dhe pakicës të Këshillit për Rregulloren, Mandateve dhe Imunitetit me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaça (neni 119/1 i Rregullores).**

(Në mbështetje të nenit 70 dhe nenit 71 pika 2, të Kushtetutës, nenin 13 pika 4 dhe pika 7, nenit 55 dhe nenit 119/1, të Rregullores së Kuvendit).

7. **Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 94/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë””, i ndryshuar.**

(Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, nenin 18 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe nenin 18, të Rregullores së Kuvendit).

8. **Projektvendim “Për disa shtesa e ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit””, i ndryshuar.**

(Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, nenin 18 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe nenin 18, të Rregullores së Kuvendit).

9. **Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit””, i ndryshuar.**
(Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, nenin 18 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe nenin 18, të Rregullores së Kuvendit).
10. **Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, i ndryshuar.**
(Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 9, pika 2 dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584 dt 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe struktura e Intitucioneve të Pavarura Kushtetuese dhe të Institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” të ndryshuar, si dhe nenit 11 pika 4, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.)
11. **Projektvendim “Për emërimin e zonjës Mimoza Kaçi, anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv”.**
(Në mbështetje të nenit neni 6, të ligjit nr. 9572 datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 641 datë 22.11.2023 “Për propozimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të kandidaturës se një anëtari të bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ushtrimin e funksionit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit”, dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit.)
12. **Projektvendim “Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Konkurrencës”.**
(Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9121, datë 29.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe nenit 111, të Rregullores së Kuvendit.)
13. **Miratimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit “Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit”.**
(Në mbështetje të neneve 77, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 24, të Rregullores së Kuvendit.)
14. **Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.**
(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)